

Përmbledhje

Si rezultat lehtësimit të masave kufizuese për ruajtjen e shëndetit të publikut, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje në gjysmën e parë të vitit 2021. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale në TM1 2021 ka shënuar rritje të përsheptuar prej 5.6 përqind. Rritja e përsheptuar e aktivitetit ekonomik vlerësohet se ka vazhduar edhe në TM2 2021, vlerësime që mbështeten në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, konsumit dhe investimeve publike, remitencave, si dhe në rritjen e prodhimit industrial dhe të tregtisë me pakicë.

Asetet e sistemit financiar në qershor 2021 arritën vlerën në 8.31 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.2 përqind. Edhe në baza tremujore, sistemi financiar u zgjerua, kryesisht mbështetur nga sektori bankar (depozitat) dhe atë pensional (kontributet e arkëtuara dhe kthimi nga investimet). Edhe sektorët tjerë kishin kontribut pozitiv në rritje, megjithëse në nivel të ulët si pasojë e peshës së vogël në sistemin financiar.

Në baza tremujore, aktiviteti i sektorit bankar në kuadër të aseteve u mbështet nga rritja e kreditimit, përderisa zërat tjerë bilancor shënuan rënie (bilanci me bankat komerciale, investimet në letrat me vlerë, dhe parasë së mbajtur në bankat komerciale). Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat shënuan rritjen më të theksuar në këtë tremujor (kryesisht mbështetur nga depozitat e arkëtuara nga ekonomitë familjare) dhe ekuiteti (fitimi i realizuar).

Sa i përket tregueseve të cilët matin shëndetin e sektorit bankar, në fund të TM2 2021, sektori rezulton të ketë qenë rritur qëndrueshmërinë përmes përmirësimit të niveli të likuiditetit, kapitalizimit, profitabilitetit si dhe cilësisë më të lartë të portfolios kreditore.

Sektori pensional u karakterizua me dinamika pozitive si në asetet e përgjithshme ashtu edhe në performancën e investimeve në TM2 2021. Rritja e kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe si dhe kthimi pozitiv nga investimet kontribuan në rritjen e aseteve të sektorit, përkundër ndikimit që kishte tërheqja e 10 përqind të mjeteve nga kontribut-dhënësit, mundësi e cila u mbyll në fillim të këtij tremujori.

Me rritje u karakterizuan edhe asetet e sektorit të sigurimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021. Gjithashtu, rritje të përsheptuar shënuan primet e shkruara bruto kundrejt dëmeve të ndodhura, e që rezultoi në performancë pozitive të sektorit në këtë tremujor.

Krahasuar me vitin e kaluar, sektori mikrofinanciar shënoi përsheptim të aktivitetit kreditor, i përkthyer në përsheptim të rritjes së aseteve në baza tremujore. Gjithashtu, sektori mbylli tremujorin e dytë me rezultat pozitiv financiar dhe nivel të kënaqshëm të cilësisë së portfolios kreditore bazuar në nivelin e ulët të kredive jo-performuese.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 100.0 milionë euro, përmes fletë obligacioneve me maturitet prej 3 deri në 10 vite. Edhe në ankandet gjatë këtij tremujori kërkesa për të investuar në fletë-obligacione qeveritare tejkaloi ofertën për 1.46 herë.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	1
Zhvillimet Makroekonomike	4
Sistemi Financiar	5
Sektori Bankar	5
Asetet	6
Performanca e sektorit bankar	11
Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar	13
Kutia 2. Kapitali shtesë kundërciklik	15
Kutia 3. Bankat me rëndësi sistemike	17
Sektori pensional	19
Sektori i sigurimeve	21
Performanca e sektorit të sigurimeve	21
Sektori mikrofinanciar	22
Asetet	22
Performanca e sektorit mikrofinanciar	24
Tregu i letrave me vlerë	26

GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	05
Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar	05
Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës	06
Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive	06
Grafik 5. Ndryshimi tremujor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare	07
Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare	07
Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake	08
Grafik 8. Depozitat sipas burimeve	08
Grafik 9. Struktura e depozita sipas kategorive kryesore	08
Grafik 9A. Depozitat e reja të arkëtuara	09
Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita	09
Grafik 11. Norma e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare	10

Grafik 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare -----	10
Grafik 13. Norma e interesit në depozita -----	10
Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare-----	11
Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	11
Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	11
Grafik 17. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione-----	12
Grafik 18. Treguesit e solvencës -----	12
Grafik 19. Treguesit e likuiditetit -----	12
Grafik 20. Asetet e sektorit pensional-----	19
Grafik 21. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	20
Grafik 22. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	20
Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	20
Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	21
Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	22
Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	22
Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare -----	23
Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë-----	23
Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	23
Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	24
Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik-----	24
Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	25
Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	25
Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore-----	25
Grafik 35. Shuma e borxhit të emetuar -----	26
Grafik 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	26
Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	26
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	28

Zhvillimet Makroekonomike¹

Si rezultat lehtësimit të masave kufizuese për ruajtjen e shëndetit të publikut, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje në gjysmën e parë të vitit 2021. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV-ja reale në TM1 2021 ka shënuar rritje të përshpejtuar prej 5.6 përqind. Rritja e përshpejtuar e aktivitetit ekonomik vlerësohet se ka vazhduar edhe në TM2 2021, mbështetur kryesisht në rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, konsumit dhe investimeve publike, remitencave, si dhe në rritjen e prodhimit industrial dhe të tregtisë me pakicë.

Çmimet e konsumit shënuan rritje prej 2.1 përqind në TM2 2021, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të mjeteve të komunikimit, transportit, pijeve alkoolike dhe duhanit, shërbimeve shëndetësore, arsimore, hoteliere, rekreacionit dhe kulturës, etj.


Përmirësimi i aktivitetit ekonomik si rezultat i zbutjes së efekteve negative të pandemisë Covid-19 është përkthyer në përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore. Të hyrat buxhetore në TM2 2021 shënuan rritje prej 45.3 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rënie prej 4.6 përqind, duke bërë që buxheti i Kosovës të regjistrojë suficit primar prej 46.9 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.6 miliardë euro, që është për 24.3 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 23.2 përqind, nga 18.2 përqind.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse është dyfishuar në TM2 2021, kryesisht për shkak të rritjes së deficitit të mallrave si dhe rënies së bilancit pozitiv të të ardhurave parësore, ndërkohë që bilanci i shërbimeve dhe i të ardhurave dytësore është përmirësuar. Deficiti tregtar i mallrave ishte 952.0 milionë euro apo 56.6 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2020, dinamikë që kryesisht i'u atribua rritjes së importit, përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit. Në kuadër të bilancit të pagesave, rritje të konsiderueshme në TM2 2021 kanë shënuar edhe remitencat (24.8 përqind) dhe IHD-të (78.8 përqind).

¹ Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM2 2021) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Sistemi Financiar

Asetet e sistemit financiar në qershor 2021 arritën vlerën prej 8.31 miliardë euro, që paraqet rritjen më të lartë vjetore në dhjetë vitet e fundit. Për më tepër, për të tretin vit me radhë asetet e sistemit financiar shënuan rritje dyshifrore (grafik 1), e që mbështetet kryesisht nga zgjerimi i sektorit bankar dhe atij pensional. Sektorët tjerë kishin ndikim pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit, por kontributi i tyre ishte i ulët.




Sektori bankar kishte kontributin kryesor në rritjen e aseteve të sistemit financiar në periudhën raportuese, asetet e të cilit shënuan rritje vjetore prej 14.8 përqind në qershor 2021 (12.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Sektori i dytë për nga madhësia në kuadër të sistemit financiar, ai pensional, vazhdoi trendin e rritjes së vitit të kaluar prej 7.5 përqind në qershor 2021 (7.6 përqind rritje vjetore në qershor 2020). Sektorët tjerë kishin kontribut pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit, por në nivel më të ulët për shkak të peshës së ulët. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të përshpejtuar të aktivitetit përdërisa ai mikrofinanciar

ngadalësim të rritjes kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 241.3 milionë euro, kryesisht ndikuar nga aktiviteti i sektorit bankar (+119.5 milionë euro) dhe sektorit pensional (+109.1 milionë euro). Sektori i sigurimeve u rrit për 5.5 milionë euro, kurse ai mikrofinanciar për 7.0 milionë euro.

Grafik 2. Ndryshimi tremujor në asete të sektorëve përbërës të sistemit financiar




Rritja e aseteve të sektorit bankar në këtë tremujor reflekton kryesisht rritjen e nivelit të depozitave si dhe kapitalit (kryesisht fitimit të realizuar në këtë periudhë); përdërisa rritja e aktivitetit të sektorit pensional i'u atribua rritjes së kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet.

Sektori Bankar

Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, aktiviteti kredidhënës ishte i vetmi zë që u karakterizua me rritje, përdërisa zërat tjerë në këtë tremujor shënuan rënie, e që ishte më e theksuar tek aktiviteti me bankat komerciale. Kurse, në kuadër të detyrimeve, depozitat dhe burimet vetanake (nga fitimi i realizuar gjatë TM2 2021) ishin kategoritë që shënuan rritjen më të lartë.

Indikatorët e shëndetit të sektorit bankar në fund të këtij tremujori ishin në nivele më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pra, sektori rriti nivelin e kapitalizmit, likuiditetit dhe shënoi përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore.

Grafik 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në trejmuorët përkatës



Asetet

Vlera e gjithsej aseteve të sektorit bankar në fund të TM2 2021 arriti në 5.57 miliardë euro, që përbën rritjen më të lartë të shënuar që nga periudha e njëjtë e vitit 2011, prej 14.8 përqind. Kjo rritje e theksuar e aktivitetit të sektorit reflekton kryesisht rritjen e nivelit të depozitave, të cilat u shfrytëzuan kryesisht për të financuar kredi-dhënie. Në baza tremujore, asetet e sektorit bankar u shtuan për 119.5 milionë euro gjatë TM2 2021. Aktiviteti kreditues i sektorit bankar (që zë peshën më të madhe në kuadër të aseteve të sektorit me pjesëmarrje prej 63.0 përqind) u shtua për 189.3 milionë euro në këtë tremujor (grafik 3). Kategoritë tjera kryesore në kuadër të aseteve shënuan rënie krahasuar me TM2 2020. Kategoria e bilancit me bankat komerciale, që janë kryesisht


depozita dhe të ngjashme të investuara në bankat jashtë vendit, shënoi rënie më të theksuar në TM2 2021 prej -51.9 milionë euro. Kategoria e investimeve në letrat me vlerë ka shënuar rënie prej -11.2 milionë euro në këtë tremujor. Po ashtu, edhe kategoria e parasë së mbajtur në trezor dhe në BQK u zvogëlua për -12.3 milionë euro në TM2 2021.

Kreditë

Vlera e gjithsej kredive aktive në fund të qershorit 2021 arriti në 3.51 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.2 përqind (rritje vjetore prej 6.4 përqind në fund të qershorit 2020). Aktiviteti kreditues përshpejtoi ritmin e rritjes krahasuar me qershor 2020, por tejkaloi edhe trendin e rritjes gjatë periudhës 2017-2019. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, me pjesëmarrje 62.8 përqind në gjithsej kreditë, shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind (6.3 përqind në fund të qershorit 2020).

Ngjashëm, edhe kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje të përshpejtuar, prej 14.8 përqind nga 6.8 përqind sa ishte në qershor të vitit 2020.

Grafik 4. Ndryshimi tremujor në stokun e kredive




Edhe në baza tremujore, aktiviteti kredi-dhënës shënoi rritje të përshpejtuar, duke kompensuar kështu

ngadalësimin e shënuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithsej kreditë në baza tremujore u shtuan për 189.3 milionë euro gjatë TM2 2021 (+44.2 milionë euro gjatë TM2 2020). Kreditë ndaj ekonomive familjare u shtuan për 77.7 milionë euro gjatë TM2 2021 (+5.1 milionë euro gjatë TM2 2020), përderisa kreditë ndaj korporatave jofinanciare u shtuan për 112.0 milionë euro (+39.7 milionë euro gjatë TM2 2020) (grafik 4).

Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, sektorët me peshën më të madhe të pjesëmarrjes në stokun e kredive aktive u karakterizuan me rritje.

Grafik 5. Ndryshimi tremujor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike




Burimi: BQK.

Kreditimi ndaj sektorëve kyç të ekonomisë, siç janë ai i tregtisë, prodhimtarisë, ndërtimtarisë dhe bujqësisë, u karakterizuan me rritje në këtë tremujor. Me rënie të kreditimit në këtë tremujor u karakterizua vetëm sektori i energjetikës.

Kreditë e reja në TM2 2021 arritën vlerën prej 494.9 milionë euro (+209.4 milionë euro në TM2 2020). Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare arritën vlerën në 265.2 milionë euro në TM2 2021 (+134.2 milionë euro në TM2 2020) (grafik 6). Rrite të theksuar shënuan kreditë për qëllime joinvestues, të cilat vetëm

në TM2 2021 arritën vlerën prej 114.8 milionë euro (+36.1 milionë euro në TM2 2020). Kreditë për qëllime investuese në këtë periudhë arritën vlerën në 145.4 milionë euro (+95.3 milionë euro gjatë TM2 2020). Në aspekt sektorial, kreditë e reja ndaj të gjithë sektorëve shënuan rritje, me theks të veçantë kredit e reja për sektorin e industrisë dhe shërbimeve.

Grafik 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare gjatë TM2



Burimi: BQK.


Ngjashëm edhe kreditë e reja ndaj ekonomive familjare shënuan rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe krahas vitit paraprak. Vlera e gjithsej kredive të reja gjatë TM2 2021 ishte për për 154.5 milionë euro më e lartë kundrejt TM2 2020, duke arritur vlerën në 229.7 milionë euro. Prej tyre, kreditë e reja për qëllim konsumi shënuan rritjen më të lartë, në 165.4 milionë euro gjatë TM2 2021 (+49.2 milionë euro gjatë TM2 2020). Ngjashëm, edhe kreditë e reja hipotekare u karakterizuan me rritje, në 53.3 milionë euro gjatë TM2 2021 (+21.3 milionë euro gjatë TM2 2020).

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (80.4 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit qershor 2021 arriti në 4.48 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej

14.7 përqind (14.0 përqind në qershor 2020). Po ashtu, edhe në baza tremujore, depozitat shënuan rritje të theksuar krahasuar me TM2 2020 (grafik 7). Kategoria e burimeve vetanake të sektorit u shtua për 33.4 milionë euro në TM2 2021 (+ 28.1 milionë euro në TM2 2020), si rrjedhojë e fitimit të realizuar në këtë periudhë. Në fund të muajit qershor 2021, stoku i gjithsej ekuitetit arriti vlerën në 675.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 18.5 përqind.

Grafik 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.


Depozitat

Për të tretin vit me radhë, në periudhën raportuese, depozitat shënuan rritje dyshifrore. Në rritjen e gjithsej depozitave kontributin kryesor vazhdojnë ta kenë ekonomitë familjare, pasuar nga depozitat e arkëtuara nga korporatat jofinanciare (bizneset) dhe korporatat tjera publike (ndërmarrjet publike).

Në baza tremujore, vetëm gjatë TM2 2021, depozitat u shtuan për 55.0 milionë euro (rritje për 57.8 milionë euro në TM2 2020). Depozitat e arkëtuara nga ekonomitë familjare gjatë TM2 2021 u shtuan për 37.0 milionë euro (+44.5 milionë euro në TM2 2020), ndërsa vlera e stokut në fund të periudhës arriti 3.07 miliardë

euro. Në anën tjetër, depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare në këtë periudhë u shtuan për 31.3 milionë euro (-9.0 milionë euro në TM2 2020), ndërsa vlera e stokut në fund të periudhës arriti në 823.3 milionë euro.


Grafik 8. Depozitat sipas burimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Depozitat e korporatave tjera financiare në këtë tremujor u zvogëluan për 19.4 milionë euro (+24.6 milionë euro në TM2 2020), e që kryesisht reflekton zhvillimet në sektorin pensional dhe strategjinë e tyre investuese (brenda dhe jashtë vendit). Në fund të periudhës, stoku i kësaj kategorie shënoi vlerën prej 250.5 milionë euro.

Grafik 9. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK.

Sipas kategorive, depozitat e transferueshme u shtuan për 59.5 milionë euro (+29.3 milionë euro në TM2 2020) në baza tremujore; kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.87 miliardë euro në fund të periudhës (qershor 2021) (grafik 9).

Në të njëjtën periudhë, depozitat e afatizuara u zvogëluan për 18.8 milionë euro (+16.2 milionë euro në TM2 2020), duke arritur vlerën prej 1.01 miliardë euro në fund të periudhës (qershor 2021). Kurse, kategoria e depozitave të kursimeve u shtua për 14.3 milionë euro (+12.4 milionë euro gjatë TM2 2020), duke arritur vlerën prej 595.0 milionë euro në fund të periudhës (qershor 2021).

Grafik 9-A. Depozitat e reja të arkëtuara, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (64.2 përqind), pasuar nga depozitat e afatizuara (22.6 përqind) dhe të kursimit (13.3 përqind).


Vlera e depozitave të reja të arkëtuara² në TM2 2021 arrit vlerën në 72.2 milionë euro, prej të cilave 53.1 milionë euro ishin depozita të arkëtuara prej

ekonomitë familjare, dhe pjesa e mbetura prej korporatave jofinanciare (grafik 9A).

Normat e Interesit³

Norma mesatare e interesit në kredi në TM2 2021 qëndroi në 6.0 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e ulët kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Ngjashëm, edhe norma mesatare e interesit në depozita shënoi ulje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me periudhën paraprake, në 1.3 përqind në TM2 2021. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.7 pikë përqindje, ngjashëm me periudhën paraprake (grafik 10).

Grafik 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë për korporatat jofinanciare qëndroi në 6.0 përqind gjatë TM2 2021, ngjashëm me periudhën paraprake (grafik 11).


Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e ulët (5.9 përqind) krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.1 përqind). Krahasuar me periudhën e

² Depozita e reja përfshijnë depozitat e afatizuara

³ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

njëjtë të vitit paraprak, ka rritje të lehtë të normës së interesit për kreditë investive (për 0.2 pikë përqindje), përderisa norma e interesit në kreditë joinvestive mbeti e pandryshuar me periudhën paraprake. Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rritje për 0.7 pikë përqindje, në 8.4 përqind në TM2 2021.


Grafik 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare



Burimi: BQK.

Ngjashëm, edhe normat e interesit në kreditë industriale shënuan rritje, për 0.2 pikë përqindje, në 6.0 përqind.

Grafik 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare



Burimi: BQK.

Norma e interesit në kreditë për sektorin e shërbimeve qëndroi e pandryshuar, në 5.9 përqind. Përderisa, norma e interesit në kreditë për sektorët tjerë shënoi


rënie, për 0.5 pikë përqindje, duke zbritur në 5.9 përqind.

Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi shënoi rënie më të theksuar, për 0.7 pikë përqindje, në 6.0 përqind gjatë TM2 2021. Norma më e lartë e interesit ishte për kreditë konsumuese (6.2 përqind), e që shënoi rënie për 0.7 pikë përqindje krahasuar me TM2 2020. Ndërsa, norma e interesit në kreditë hipotekare në TM2 2021 qëndroi në 5.1 përqind, një rënie prej 0.9 pikë përqindje krahasuar me me TM2 2020 (grafik 12).

Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita shënoi rënie marxhinale krahasuar me periudhën paraprake (për 0.2 pikë përqindje), në 1.3 përqind (grafik 13).

Grafik 13. Norma e interesit në depozita




Burimi: BQK.

Normat e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me ato për ekonomitë familjare, edhe pse dallimi mes tyre nuk është i lartë.

Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare qëndroi në 1.7 përqind (1.5 përqind në TM2 2020) (grafik 14).


Grafik 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive



Burimi: BQK.

Kurse, normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënuan rënie marxhinale krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare qëndroi në 1.3 përqind (1.5 përqind në TM2 2020) (grafik 15).

Grafik 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK.


Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në TM2 2021 realizoi fitim në vlerë prej 30.1 milionë euro, e që është për 12.3 milionë euro më i lartë krahasuar me TM2 2020 (grafik 16). Fitimi më i lartë i realizuar në TM2 2021 ishte kryesisht rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (për 12.5 milionë euro) kundrejt rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve

(për 0.3 milionë euro). Të hyrat gjatë këtij tremujori arritën vlerën në 78.0 milionë euro, ku të hyrat nga interesi (kryesisht të hyra nga interesi në kredi) arritën vlerën prej 56.8 milionë euro (rritje vjetore për 7.1 milionë euro). Në anën tjetër, edhe të hyrat nga jo-interesi (kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet), shënuan rritje vjetore për 5.2 milionë euro krahasuar me TM2 2020 dhe arritën vlerën prej 19.0 milionë euro në fund të tremujori të dytë 2021.

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan vlerën prej 47.9 milionë euro në TM2 2021. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, shënuan vlerën prej 29.2 milionë euro, që paraqet një rritje për 2.8 milionë euro krahasuar me TM2 2020. Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit shënoi vlerën prej 9.4 milionë euro në TM2 2021 (për 3.8 milionë më e ulët se në periudhën paraprake), kryesisht si rezultat i ndarjes më të ulët të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi. Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit gjatë kësaj periudhe u zvogëlua për vetëm 0.2 milionë euro, duke zbritur në vlerën prej 5.8 milionë euro në TM2 2021.

Grafik 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK.

Rritja e theksuar e të hyrave në këtë tremujor (19.1 përqind) kundrejt rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve (0.6 përqind), ndikoi që raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të përmirësohet duke zbritur në nivelin prej 61.4 përqind në TM2 2021. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar, sektori bankar shpenzon 0.614 euro (grafik 16).

Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të jenë në nivel të kënaqshëm edhe gjatë TM2 2021, duke tejkaluar minimumet e kërkuara me rregullore dhe përmirësuar edhe më tej krahasuar me TM2 2020.

Grafik 17. Kredite joperformuese dhe mbulueshmeria me provizione




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
 Burimi: BQK.

Kredite joperformuese ndërprejnë trendin rritës që kishte karakterizuar sektorin bankar që nga TM1 2020 (me shfaqjen e pandemisë Covid-19); për herë të parë në TM2 2020. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në qershor 2021 qëndroi në nivel prej 2.5 përqind (2.7 përqind në fund të qershorit 2020) (grafik 17). Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të provizionuara, në shkallë prej 143.2 përqind (129.0 përqind në fund të qershorit 2020).

Si rezultat i nivelit të kapitalit të trashëguar nga vitet paraprake dhe fitimit të realizuar në tremujorin e dytë të vitit 2021, niveli i kapitalizimit të sektorit bankar qëndroi në nivele të kënaqshme. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 17.3 përqind në periudhë raportuese, nivel ky më i lartë për 0.5 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 18).


Grafik 18. Treguesi i solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
 Burimi: BQK.

Rritja e këtij treguesi i atribuohet rritjes më të lartë të gjithsej kapitalit krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të mjeteve të peshuara me rrezik.

Grafik 19. Treguesit e likuiditetit



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
 Burimi: BQK.

Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra


shënoi përmirësim të lehtë, për 0.6 pikë përqindje krahas gjendjes në fund të TM2 2020, duke qëndruar në nivel prej 36.7 përqind. Rritja e këtij indikatori kryesisht i'u atribua rritjes më të përshpejtuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme dhe ekuivalentët e saj, bilancit me bankat tjera, investimeve në letrat me vlerë), krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra (kryesisht depozitave të transferueshme).

Kutia 1. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar

Sektori bankar, para përhapjes së pandemisë Covid-19, ka operuar përgjithësisht në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve. Mirëpo, që nga gjysma e dytë e muajit mars 2020 kur filluan të ndërmerren masa për mitigimin e pasojave shëndetësore nga kriza e re pandemike, rreziqet potenciale ndaj stabilitetit financiar u rritën. Megjithëse edhe gjatë vitit 2020, sektori bankar vazhdoi të ruaj nivelin e likuiditetit, solvencën, profitabilitetin dhe cilësinë e portfolios kreditorë, gjashtëmuajori i parë i vitit 2021 u karakterizua me përmirësim në indikatorët kyç të cilët matin shëndetin e sektorit bankar. Mbështetur në tregues me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, është ndërtuar Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar, për matjen dhe vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.⁴ Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rritje të indeksit) në TM2 2021 krahasuar me TM2 2020. Vlera e përgjithshme e indeksit në TM2 2021 është mbi vlerën mesatare të indeksit (grafik 1), për dallim nga viti paraprak ku si pasojë e krizës pandemike, indeksi i përgjithshëm rezultoi të jetë nën vlerat mesatare historike në secilin tremujor.

Grafik 1. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BOK.

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, të gjithë indikatorët përbërës të indeksit të përgjithshëm të stabilitetit të sektorit bankar u karakterizuan me ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (lexo: rritje të indeksit). Uljen më të lartë të ndjeshmërisë shënuan indikatorët e profitabilitetit, pasuar nga indikatorët e rrezikut kreditor, solvencës dhe likuiditetit. Vlen të theksohet që indikatorët që matë rrezikun e tregut ka peshë relativisht të ulët në indeksin e përgjithshëm dhe lëvizjet në këtë indikator deri tani nuk paraqesin rrezik për sektorin bankar si rrjedhojë e nivelit të ulët të mjeteve të mbajtura në valutë të huaj (grafik 2).

Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës në fund të TM2 2021 krahasuar me gjendjen në fund të TM2 2020 i atribuohet rritjes së kapitalizimit të sektorit bankar. Në rritje të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e kapitalit rregullativ kundrejt rritjes më të ngadalësuar të aseteve që bartin rrezik.

⁴ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.


Grafik 2. Kriteret përbërëse të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit në TM2 2021 krahasuar me nivelin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të mjeteve likuide krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të detyrimeve afatshkurtra. Në kuadër të mjeteve likuide, kemi rritje të theksuar të parasë së mbajtur në BQK, bankat tjera komerciale dhe institucionet tjera financiare, si dhe investimeve në letrat me vlerë. Në anën tjetër, detyrimet afatshkurtra shënuan rritje më të ngadalësuar kundrejt mjeteve likuide, e që kryesisht janë depozita të cilat maturajnë brenda një vitit.

Grafik 3. Indikator i solvencës



Burimi: BQK.


Grafik 4. Indikator i likuiditetit



Burimi: BQK.

Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor kryesisht i'u atribua ngadalësimit të rritjes së vlerës së kredive joperformuese, ndërsa si nivel shënuan rënie kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënie erdhi si rezultat i rritjes së përshpejtuar të aktivitetit kreditues deri në qershor 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Lehtësimi i masave anti-Covid 19 dhe ringjallërimi ekonomik në TM2 2021 rezulton të jetë reflektuar pozitivisht si në kërkesën për kredi ashtu edhe në ofertën kreditore.

Grafik 5. Indikator i rrezikut kreditor




Burimi: BQK.

Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit i atribuohet zhvillimeve në të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar gjatë kësaj periudhe. Rritja e të hyrave të sektorit për 19.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte rezultat i të hyrave nga interesi (kryesisht nga kreditë) dhe atyre nga jointerеси (kryesisht tarifave dhe komisioneve).

Kurse, shpenzimet shënuan rritje për vetëm 0.6 përqind, e që reflekton ecurinë e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, përderisa me rënie u karakterizuan shpenzimet nga jointerеси dhe interesi. Në rënie të shpenzimeve nga jointerеси kontributin kryesor kishin zvogëlimi i shpenzimeve të përovizioneve për humbjet e mundshme në kredi. Operimi në një ambient më profitabil krahasuar me një vit më parë, ka ndikuar edhe në përmirësim të treguesit të profitabilitetit, siç është kthimi në mesataren e kapitalit (KMK).


Grafik 6. Indikator i profitabilitetit



Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut i'u atribuua uljes së pozicionit neto në valutë të huaj të sektorit bankar. Ky indikator ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak të nivelit të ulët të ekspozimeve si në asete dhe detyrime Për më tepër, edhe niveli i kredive dhe depozitave në valutë të huaj është

në nivel mjaftë të ulët. Si rrjedhojë, lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaftë të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar.

Grafik 7. Indikator i rrezikut të tregut



relevante duhet të gjykojnë relevancën e aplikimit të kërkesave kundër-ciklike të kapitalit.

BQK, në Politikën për Makroprudencë, liston instrumentin e kërkesave kundër-ciklike të kapitalit si instrument të mundshëm të objektivit të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale për zvogëlimin dhe parandalimin e rritjes së tepruar të kredive dhe të levës. Konform udhëzimeve të Bazelit, parametri kryesor për përcaktimin e normës së Kapitalit shtesë kundër-ciklik theksohet të jetë hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (BPV) në Kosovë, krahas tregueseve të tjerë relevant që do të informojnë vendimin përfundimtar për aktivizimin e mundshëm të instrumentit.

Devijimi i raportit të kreditimit ndaj BPV-së nga trendi i tij afat-gjatë paraqet parametrin kryesor të modelit. Llogaritja e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së bëhet duke u mbështetur në udhëzimet e Bazelit si dhe praktikat e unifikuara të mënyrës së kalkulimit nga shumica e vendeve në botë të bazuara në rekomandime nga hulumtimet

Kutia 2. Kapitali shtesë kundërciklik⁵

Kapitali shtesë kundër-ciklik ka për qëllim forcimin e stabilitetit financiar përmes mbrojtjes së sektorit bankar ndaj humbjeve që mund të shkaktohen nga akumulimi i rrezikut sistemik ciklik në një ekonomi, si dhe përmes ndikimit në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofertës kreditore përgjatë gjithë ciklit financiar. Kapitali shtesë kundër-ciklik është pjesë e kornizës rregullative të Bazelit III dhe njëherësh një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar dimensionin ciklik të rrezikut sistemik.

Për llogaritjen e kapitalit shtesë kundër-ciklik, udhëzimet e Komitetit për Mbikëqyrje Bankare të Bazelit sugjerojnë monitorimin e disa parametrave për vlerësimin nëse kreditimi është duke u rritur përtej fundamentaleve të qëndrueshme dhe rrjedhimisht është duke ndikuar në akumulimin e rrezikut sistemik. Krahas vlerësimit të parametrave sipas udhëzimeve përkatëse, autoritetet

⁵ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.13.

empirike, përmes filterit të njëanshëm Hodrik-Prescott (parametri zbutës 400,000).


Në kreditim janë përfshirë kreditë ndaj sektorit privat nga bankat si dhe institucionet financiare jo bankare. Përfshirja e kredive të sektorit jo bankar përkundër që ka pjesëmarrje të ulët dhe aktualisht pa ndonjë efekt të theksuar në rezultat të hendekut të kreditimit, siguron konsistencë në mënyrën e llogaritjes me vendet tjera, si dhe siguron që të përfshihen efektet e rritjes së mundshme të peshës së kreditimit ndaj sektorit privat nga institucionet financiare jo bankare.

Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së në Kosovë në qershor të vitit 2021 qëndroi në 52.9 përqind. Rezultatet e hendekut të kreditimit në fund të qershorit 2021 sugjerojnë që sektori privat në Kosovë ka kaluar në të ashtuquajturën periudhë të ‘mbi kreditimit’. Periudha e ‘mbi kreditimit’ shënon që nga tremujori i parë i vitit 2021, e që është kryesisht si pasojë e tkurrjes së paprecedent ekonomike në vitin 2020 dhe efekteve të bartuara në vitin 2021, përderisa kreditimi ka ruajtur ritmin pozitiv të rritjes (përsheptim të rritjes në qershor 2021 krahasuar me gjendjen e një viti më parë).

Si rrjedhojë, në qershor 2021, hendeku i kredisë ndaj BPV-së rezulton në 3.302 përqind, më i zgjeruar në rrafshin pozitiv krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (+0.736 përqind) (grafik 1).


Zgjerimi pozitiv i hendekut të kredisë ndaj BPV-së në dy periudhat e fundit nënkupton që kreditimi është duke u rritur me ritëm më të shpejtë kundrejt bruto produktit vendor. Përderisa në kushte normale, kjo dinamikë sugjeron mbi-kreditim dhe sinjalizim për akumulim të rrezikut sistemik, në rastin konkret është më shumë efekt i përkohshëm i shkaktuar nga kriza pandemike (rënia e paprecedent ekonomike në vitin 2020).

Grafik 1. Hendeku i kreditimit



Rrjedhimisht në dhënien e një vlerësimi gjykues të ciklit kreditues duhet patjetër të konsiderohen edhe indikatorët e tjerët financiar dhe ekonomik, dhe në veçanti gjykimi i ekspertëve.

Grafik 2. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Gjithashtu, indikatorë tjerë relevant monitorohen në baza të rregullta krahas hendekut të kreditimit, të cilëve së bashku me informacionet kualitative dhe gjykimin e ekspertëve relevant, iu alokohet peshë e veçantë në formimin e gjykitimit përfundimtarë rreth zhvillimeve në fushën e rrezikut sistemik dhe raportit të kredisë ndaj BPV-së. Këta indikatorë, ndër tjera, përfshijnë dinamikën e rritjes kreditore të përgjithshme dhe rritjen në sektorë specifik, ekspozimet kreditore në sektorë të veçantë, raportin e kredisë ndaj kolateralit, raportin e borxhit ndaj të hyrave, etj.

Kutia 3. Bankat me rëndësi sistemike⁶


Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të dimensionit strukturor dhe ndër-sektorial të

rrezikut sistematik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike (tabela 1). Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit qershor 2021, tregojnë që pesë banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike, ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 1).

Tabela 1. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë

Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 25%)	Asetet (pa provizione)
Zëvendësueshmëria (pesha 25%)	Vlera e transaksioneve në raport me gjithsej vlerën e transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 25%)	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksitetit (pesha 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jasht-bilancor

Grafik 1. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK.

Të pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar me rëndësi sistemike pothuajse në të gjitha kriteret përbërëse të modelit. Kurse, bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike, nuk kanë rezultuar të tilla në asnjërin prej indikatorëve. Mirëpo, nëse shikohen sub-indikatorët, ka raste kur kanë rezultuar sistemike në atë sub-indikatorë 6 banka (maksimumi)

përkatësisht 2 banaka (minimumi). Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,179 pikë bazë deri në 2,118 pikë bazë. Kjo paraqet rënie më të ngadalësuar të shkallës së sipërme sistemike (rënie për 30 pikë bazë) kundrejt rënies së shkallës më të ulët të rëndësisë sistemike (rënie për 59 pikë bazë).


Në përgjithësi, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike, kanë ulur shkallën e pikëve sistemike, kundrejt rritjes së shkallës së pikëve të bankave që nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në rritje të shkallës së pikëve të bankave që nuk kanë rezultuar sistemike ka ndikuar edhe fillimi i operimit të një banke të re me kapital nga Shqipëria, e cila është licencuar në tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

Kriteri i madhësisë: shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,237 pikë bazë në 2,146 pikë bazë. Katër nga pesë bankat me rëndësi sistemike u karakterizuan me rënie të rëndësisë sistemike në këtë kriter krahasuar me

⁶ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull 'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

periudhën paraprake (grafik 2). Ky është një indikacion për rënie të shkallës së koncentrimin prej bankave më të mëdha, e që do të ndikoj në rritje të konkurrencës dhe ofrim të shërbimeve më cilësore dhe më të favorshme për qytetarët dhe bizneset.


Grafik 2. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK.

Kriteri i zëvendësueshmërisë: shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,142 pikë bazë në 2,330 pikë bazë (grafik 3). Tri nga pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë shënuar rënie të shkallës sistemike në këtë kriter krahasuar me periudhën e kaluar. Përderisa, me rritje u karakterizuan shumica e bankave të rëndësisë së përgjithshme jo-sistemike. Kjo u reflektua pothuajse në të gjitha nënkategoritë përkatëse.


Grafik 3. Kriteri i zëvendësueshmërisë



Burimi: BQK.

Kjo dinamikë u vu re në nënkategoritë e kreditimit për korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare, si dhe depozitave të arkëtuara prej ekonomive familjare. Përderisa, vetëm në indikatorin e transaksioneve ndërbankare ka rritje josignifikante tek bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kundrejt rënies tek bankat e vogla.


Grafik 4. Kriteri i ndërlidhjes



Burimi: BQK.

Kriteri i ndërlidhjes: ky kriter karakterizohet me luhatjet më të mëdha ngase bankat mund të ndërrojnë me lehtësi bilancin e tyre ndaj institucioneve financiare, si dhe investimet në letrat me vlerë. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,245 pikë bazë në 2,567 pikë bazë (grafik 4).

Grafik 5. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Burimi: BQK.

Bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike rritën shkallën e pikëve konsiderueshëm kundrejt rënies së shkallës së pikëve tek bankat të cilat nuk kanë rezultuar të kenë rëndësi të përgjithshme sistemike. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit më të theksuar me bankat dhe institucionet financiare nga bankat e mëdha, krahasuar me nivelin më të ulët të ndërveprimit prej bankave të vogla.

Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit: shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,207 pikë bazë në 2,560 pikë bazë (grafik 5). Krahasuar me periudhën paraprake, shkalla e rëndësisë sistemike ka


shënuar rënie kundrejt rritjes së shkallës nga bankat josistemike. Kjo erdhi si rezultat i ndërveprimit më të lartë me sektorin e jashtëm nga bankat jo-sistemike krahasuar me ndërveprimin prej bankave me rëndësi të përgjithshme sistemike.

Në përgjithësi, duhet theksuar se sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapitalit për bankat me rëndësi sistemike, mbi kapitalin e klasit të parë siç rekomandohet nga Bazeli dhe ABE, nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit rregullator të sektorit bankar në Kosovë.

Sektori pensional

Si pasojë e performancës së kënaqshme të investimeve në tregjet financiare, aktiviteti i sektorit pensional gjatë TM2 2021 u zgjerua. Ky zgjerim i atribuohet kryesisht kthimit pozitiv në investime dhe kontributeve të arkëtuara nga kontribut-dhënësit.

Grafik 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.


Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 26.5 përqind të gjithëj aseteve të sistemit financiar. Pavarësisht tërheqjes së

mjeteve nga kontribut-dhënësit në nivel prej 10 përqind, mundësi e cila u përbyll në fillim të tremujorit të dytë, gjithsej asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 7.5 përqind në qershor 2021 dhe arritën vlerën prej 2.16 miliardë euro. Kurse, në baza tremujore, vetëm gjatë TM2 2021, asetet e sektorit pensional u rritën për 109.1 milionë euro (rritje për 93.9 milionë euro në TM2 2020) (grafik 20).

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloven-Kosovar të Pensioneve (FSKP).

Struktura e aseteve të FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, por që pesha e tyre gradualisht është zvogëluar kundrejt rritjes së peshës së mjeteve të investuara në vend. Rreth 72.3 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë vendit. Saktësisht, në vlera monetare, rreth 1.50 miliardë euro janë të alokuara në fonde të përbashkëta investuese dhe 57.6 milionë euro janë para në transit (grafik 21).

Grafik 21. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM2 2021)



Burimi: FKPK.


Pjesa e mbetur e mjeteve u investuan brenda vendit, dhe arritën vlerën prej 596.0 milionë euro në fund të qershorit 2021. Këto mjete janë kryesisht të investuara në fletë-obligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat vetëm gjatë TM2 2021 u rritën për 19.9 milionë euro. Paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës po ashtu shënoi rritje prej 3.0 milionë euro. Përderisa, kategoria e mjeteve të deponuara në sektorin bankar u tkurr për 17.1 milionë euro në këtë tremujor.

Struktura e mjeteve të FSKP-së është e ngjashme me atë të FKPK-së, ku rreth 77.4 përqind e tyre janë të investuara jashtë vendit, dhe pjesa e mbetur në Kosovë. Portfolio e FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (65.4 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (19.5 përqind), paraja e gatshme (7.6 përqind) dhe instrumentet tjera (7.4 përqind) (grafik 22). Gjithsej asetet e FSKP-së gjatë TM2 2021 u rritën për 246.3 mijë euro, prej të cilave pjesa më e madhe ishin investime në sektorin e brendshëm.

Gjatë TM2 2021 FSKP-ja kishte kthimi negativ në investime në vlerë prej -132.6 mijë euro (-1.6 milionë

euro në TM2 2020). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit gjatë TM2 2021 arriti në 123.5` mijë euro (128.5 mijë euro në TM2 2020).


Grafik 22. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM2 2021)



Burimi: FSKP.

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK-së u shtuan në vlerë prej 52.0 milionë euro, një rritje për 23.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grafik 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 76.4 milionë euro gjatë TM2 2021, krahasuar me kthimin prej 70.3 milionë euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Përveç zbatimit të politikave investuese, performanca e kënaqshme e FKPK u ndikua po ashtu nga diversifikimi i portfolios së fondit

përmes instrumenteve të reja financiare, duke lejuar kthim më të mirë dhe shpërndarje të rrezikut.


Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit. Njëkohësisht, vlera e primeve të arkëtuara tejkaloi vlerën e dëmeve të paguara në veçanti dhe shpenzimeve të sektorit në përgjithësi, gjë që rezultoi në performancë pozitive të sektorit në TM2 2021.

Asetet e sektorit të sigurimeve deri në fund të muajit qershor 2021 arritën në vlerën 230.0 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 10.3 përqind. Depozitat e mbajtura në bankat komerciale dhe investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishin zërat me rritjen më të lartë. Kurse, vetëm gjatë TM2 2021, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 5.5 milionë euro (grafik 24), rritje e mbështetur kryesisht nga të arkëtueshmet nga të siguruarit, investimet në letrat me vlerë, si dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale.

Në kuadër të kapitalit dhe detyrimeve, në këtë tremujor rritjen më të lartë shënuan rezervat teknike, kryesisht për primet. Kurse, rezervat për dëmet u rritën në nivel më të ulët. Niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali u rrit për 1.1 milionë euro, kurse vlera në fund të qershorit 2021 ishte 60.0 milionë euro. Gjithsej detyrimet e sektorit shënuan rritje gjatë kësaj periudhe për 4.4 milionë euro, dhe vlera e tyre në fund të qershorit 2021 arriti në 170.1 milionë euro.

Grafik 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në TM2 2021 arriti në 29.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 26.2 përqind (9.4 përqind rënie vjetore në TM2 2020) (grafik 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 96.0 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 4.0 përqind.


Vlera e dëmeve të paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënoi rritje gjatë TM2 2021 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Në TM2 2021, dëmeve të paguara arritën vlerën prej 15.6 milionë euro (9.5 milionë euro në TM2 2020) (grafik 25). Pasi si përqindje, dëmet gjatë kësaj periudhe patën rritje më të lartë se sa primet e shkruara, raporti dëme/prime në TM2 2021 u rrit krahasuar me periudhën paraprake, në 53.6 përqind (grafik 25).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Gjatë TM2 2021, sektori i sigurimeve performoi me fitim neto në vlerë prej 2.1 milionë euro (fitim neto në vlerë prej 3.2 milionë euro në TM2 2020).⁷

Rezultatet pozitive financiare gjatë këtij tremujori reflektojnë kryesisht nivelin më të lart të arkëtimeve prej primeve të shkruara krahasuar me nivelin e dëmeve të ndodhura.

Grafik 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e aseteve të sektorit, kryesisht e ndikuar nga rritja e aktivitetit kreditor, si dhe rritja e të hyrave kundrejt rënies së shpenzimeve rezultuan në performancë pozitive të sektorit gjatë këtij tremujori. Cilësia e portfolios së kredive të sektorit vazhdoi të mbetet stabile, bazuar në normën e ulët të kredive jo-performuese.

Asetet

Sektori mikrofinanciar regjistroi rritje vjetore të ngadalësuar të aseteve prej 3.0 përqind (9.9 përqind rritje vjetore në qershor 2020), vlera e të cilave arriti në 322.8 milionë euro në fund të qershorit 2021. Mirëpo, në baza tremujore, asetet kishin rritje të përshpejtuar prej 7.0 milionë euro gjatë TM2 2021 krahasuar me rritjen prej 3.4 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafik 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK.

Pritjet për lirim të masave kufizuese gjatë tremujorit të dytë dhe rritjen e hyrjeve në vend nga diaspora u përkthyen në rritje të besueshmërisë së sektorit në aftësinë paguese të konsumatorëve, pritje që u përkthyen në rritje të kërkesës por dhe ofertës kreditore dhe për rrjedhojë, në rritje të aseteve të sektorit mikrofinanciar.


Kreditë

Në baza vjetore, gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje për 4.6 përqind në fund të muajit qershor 2021, përderisa stoku i tyre arriti në

⁷ Fitimit neto i është larguar fitim/humbja e kompanisë së sigurimit të cilës i është revokuar licence në vitin 2019


218.4 milionë euro. Kreditimi i sektorit u rrit për të dy kategoritë, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje prej 3.9 përqind (0.3 përqind rënie vjetore në qershor 2020), duke arritur vlerën 143.7 milionë euro në fund të qershorit 2021. Kurse, vetëm gjatë TM2 2021, kreditë ndaj ekonomive familjare u rritën për 6.0 milionë euro (grafik 27).

Grafik 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, ndryshimi tremujor



Stoku i kredive ndaj korporatave jo-financiare në fund të qershorit 2021 arriti vlerën prej 74.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.0 përqind (rritje vjetore prej 5.4 përqind në qershor 2020).

Grafik 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor




Përderisa, në baza tremujore, gjatë TM2 2021, kreditë ndaj korporatave jo-financiare u rritën për 3.4 milionë euro.

Në aspekt sektorial, në baza tremujore, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve kishte rritje, përveç 'shërbimeve tjera'. Megjithatë, rritja në kreditim ishte më e ulët për pjesën më të madhe të sektorëve. Rritjen më të lartë e kishte sektori i tregtisë, pasuar nga sektori i bujqësisë. Përderisa, kreditimi ndaj sektorit të industrisë dhe industrive tjera stagnoi në TM2 2021 (grafik 28).

Lizingjet

Në baza tremujore, edhe lizingjet u zgjeruan gjatë TM2 2021, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me aktivitetin kredi-dhënës të sektorit mikrofinanciar. Aktiviteti i lizingut shënoi rritje në vlerë prej 1.8 milionë euro në TM2 2021 (0.5 milionë euro në TM2 2020), dhe arriti vlerën prej 59.4 milionë euro në fund të periudhës.

Grafik 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jo-financiare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 1.6 milionë euro dhe arriti në 33.4 milionë euro në fund të periudhës (grafik 29).

Gjithashtu, edhe lizingu ndaj ekonomive familjare u rrit për 0.2 milionë euro gjatë TM2 2021, përdërisa vlera e përgjithshme e tyre në fund të qershorit 2021 arriti në 26.0 milionë euro.

Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor qëndroi në 19.7 përqind, që është për 0.6 pikë përqindje më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 30).

Grafik 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Norma e interesit për kreditë e ekonomitë familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje, në 21.4 përqind gjatë TM2 2021 (grafik 30). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u zvogëlua për 2.7 pikë përqindje në 19.9 përqind në TM2 2021. Kurse, për kreditë konsumuese, norma e interesit kishte rritje për 2.5 pikë përqindje, në 23.2 përqind.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua, për 0.5 pikë përqindje, në 17.2 përqind. Në aspekt sektorial, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për

sektorin e shërbimeve, pasuar nga kreditë për sektorin e industrisë.

Grafik 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Norma mesatare tremujore e interesit për kreditë e shërbimeve dhe industrisë shënoi rënie vjetore për 2.3 përkatësisht 2.4 pikë përqindje. Kurse, rritje për 1.2 pikë përqindje shënuan normat e interesit për kreditë ndaj sektorit të bujqësisë (grafik 31).


Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar mbylli tremujorin e dytë të vitit 2021 me fitim neto në vlerë prej 5.2 milionë euro, prej tyre 2.3 milionë euro u shtuan gjatë TM2 2021. Kurse, gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, ky sektor kishte operuar me humbje në vlerë prej 3.1 milionë euro. Performanca pozitive financiare në këtë tremujor ishte kryesisht rezultat i rënies së shpenzimeve kundrejt rritjes së të hyrave. Të hyrat e sektorit gjatë këtij tremujori shënuan vlerën prej 11.6 milionë euro, që paraqet një rritje për 0.9 milionë euro krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja i'u atribua rritjes së të hyrave nga interesi për 0.5 milionë euro në 10.5 milionë euro gjatë TM2 2021 (grafik 32). Gjithashtu, të hyrat nga jo-interesi u rritën për 0.4

milionë euro, duke arritur në 1.1 milionë euro, ku rritja e të hyrave tjera operative ka peshën më të madhe në rritje.

Shpenzimet e sektorit shënuan vlerën prej 9.1 milionë euro gjatë TM2 2021, vlerë e cila është për 2.1 milionë euro më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jo-interesi, saktësisht provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet nga interesi shënuan rënie të lehtë, ndërsa shpenzimet operative shënuan rritje.

Grafik 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim të dukshëm, duke u zvogëluar për 26.2 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në nivel prej 78.6 përqind në TM2 2021. Kjo do të thotë që për çdo 1 euro të investuar, sektori mikrofinanciar ka shpenzuar rreth 0.786 euro.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit

(KMK), të cilët shënuan rritje të konsiderueshme në TM2 2021 në 3.1 përqind dhe 12.7 përqind, përkatësisht krahasuar me vlerat negative në TM2 2020 (grafik 33).


Grafik 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK.

Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore të institucioneve mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione. Deri në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në nivel prej 3.1 përqind, përderisa mbulueshmëria e KJP-ve me provizione në fund të TM2 2021 ishte 136.6 përqind (grafik 34).

Grafik 34. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore




Burimi: BQK.

Tregu i letrave me vlerë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2021, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë më të ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit 2020, mirëpo më të lartë se sa në tremujorin paraprak. Po ashtu, kërkesa për investim në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës tejkaloi ofertën për të njëjtat.

Grafik 35. Shuma e borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave.

Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës në TM2 2021 shënoi rënie vjetore prej 38.4 përqind krahasuar me TM2 2020, duke rezultuar në vlerën prej 100.0 milionë euro (grafik 35).

Kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të tejkalojë ofertën, që në TM2 2021 ishte për 1.46 herë më e lartë se sa shuma e kërkuar. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM2 2021 ishte 2.3 përqind, normë e njëjtë me atë të aplikuar gjatë TM2 2020 (grafik 36). Rritja e normës së interesit krahasuar me periudhën paraprake reflekton trendin e emetimit të letrave me vlerë drejtë maturimeve afatgjata.


Grafik 36. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave.

Pra, struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitetet prej 3 vite, pasuar nga ato me maturitetet prej 5 dhe 7 vite (grafik 37).

Grafik 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Vlen të cekët që për të dytin vit me radhë, nuk kemi emetim të bonove të thesarit, maturiteti maksimal i të cilave është 364 ditë.

Spektori bankar, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, ku sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2021): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 35, TM2 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2021):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <https://bqk-kos.org/publikimet/buletini-mujor-statistikor/>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/>

ASK (2021):

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-çmimeve-te-konsumit-ihck-qershor-2021>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-çmimeve-te-prodhimit-icp-tm2-2021>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-çmimeve-te-importit-icimp-tm2-2021>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/reportori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm2-2021>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-qershor-2021>
- f) Buletini Tremujor: [Buletini Tremujor | \(rks-gov.net\)](http://rks-gov.net)

Të tjera (2021):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Bloomberg (2021): Metal Prices database: [Commodities - Bloomberg](https://www.bloomberg.com/professional/data/commodities/)

FAOUN (2021): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2021): Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2021): World Economic Outlook: [World Economic Outlook \(imf.org\)](https://www.imf.org/en/Publications/WEO/)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2020	Qershor 2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	1,409.9	1,492.6
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.6%	1.3%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.1%	2.4%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	760.3	982.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	877.5	968.3
Bilanci primar (në milionë euro)	-117.2	14.2
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,406.9	8,309.2
prej të cilave: Bankat	4,849.0	5,568.9
Kredi	3,127.4	3,510.1
Depozita	3,903.2	4,477.8
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.3%	6.0%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.5%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	4.7%	4.7%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-217.3	-449.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	434.9	552.0
Llogaria financiare	-311.8	-256.9
Investimet e huaj direkte në Kosovë	173.5	230.1
Investimet portfolio, net	-389.1	42.1
Investimet tjera, net	195.5	-132.2
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-592.2	-887.4
Asetet	5,054.3	5,348.4
Detyrimet	5,646.6	6,235.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,206.9	2,513.8
Borxhi i jashtëm privat	1,717.5	1,907.3
Borxhi i jashtëm publik	489.4	606.5

Burimi:

1/ ASK (2021);

2/ MF (2021);

3/ BQK (2021).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në mars 2021.

